



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2018

SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT- ORIENTUESE

Varianti B

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

PJESA I

Shkëmbi

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	D	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 1 pikë

➤ **Ndikimi i pasionit:**

- *Djali nuk ndoqi atë që të tjerët kishin zgjedhur për të, por zgjodhi atë që donte më shumë, pasionin e tij.*
- *Djali ndryshoi drejtimin e jetës, vetëm për shkak të pasionit.*
- *Ai zbuloi papritur pasionin e tij që do të bëhej zgjedhja e jetës së tij.*

1 pikë Nëse shpjegon në ç'mënyrë pasioni ndikoi në jetën e tij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 9 3 pikë

➤ **Lloji i tekstit:** *rrëfyes*

➤ **Karakteristikat:**

- kohë dhe vende të përcaktuara;
- ka një protagonist të ngjarjes;
- ka kronologji;
- koha e foljeve (e kryera e thjeshte, tregon ngjarjen dhe e pakryera për të përshkruar situatën);
- të dhënat hapësinore dhe vendore (ndajfolje kohe, vendi);
- përdorimi i vetës I, III.

1 pikë Nëse gjen llojin e tekstit të cilit i përket paragrafi i pestë.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy karakteristika që i takojnë këtij lloji teksti.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një karakteristikë që i takojnë këtij lloji teksti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **3 pikë**

➤ **Detaje shqisore:**

- e poshtme, e vogël, e zezë, të ndritshme, e zbehtë, e zmadhuar, ngjyrë portokalli, valëzuese, të vogël.

➤ **Funksioni:**

- *Detajet shqisore i shtohen rrëfimit me efekt përshkrues-informues;*
- *Të nxisë te lexuesi imazhin e përfytyrimit;*
- *Të joshë lexuesin që edhe ai si shkruesi, të mundet të gjejë pasionin në jetë.*

2 pikë Nëse identifikon dy detaje shqisore të shprehura me mbiemër.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një detaj shqisor të shprehur me mbiemër.

DHE

1 pikë Nëse tregon funksionin që ato luajnë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetaj 11 (a) **2 pikë**

➤ **Figura:** Metaforë

➤ **Nënteksti:**

- *Ai gur ishte mundësia për të kuptuar se çfarë donte me të vërtetë në jetë.*
- *Ai gur ishte si hapja e syve dhe e mendjes për të parë dhe kuptuar me qartë se çfarë donte të arrinte në jetë, të bënte realisht në të ardhmen.*
- *Guri është si porta ose si faqja që duhet hapur apo kthyer për të parë se çfarë ka në anën tjetër, për të zbuluar të panjohurën dhe kuptuar atë. Por pa e kthyer gurin ai s' mund ta dinte, në momentin që e ktheu ai e kuptoi atë që donte.*

1 pikë Nëse identifikon figurën bazë.

1 pikë Nëse zberthen nëntekstin që mbart fjalë e dhënë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 11 (b) 3 pikë**➤ Shpjegimi:**

- Mënyra si e sjell autori përshtypjen e tij për botën nënshkëmbore, është e veçantë; ai zgjedh përdorimin e fjalisë *habitore* në krye të paragrafit. Përmes saj nxit lexuesin të zbulojë botën ashtu si shkruesi.

➤ Efekti kuptimor:

- *Botë që e befason autorin, e panjohur më parë.*
- *Poshtë atij shkëmbi të vogël, nën atë ranishte të lagur ai zbuloi një botë të tërë nënujore, por edhe një anë tjetër të botës së tij të brendshme shpirtërore të panjohur më parë.*

➤ Efekti stilistik

- *Pasthirrma fton lexuesin të jetë pjesë e këtij komunikimi.*
- *Nxit lexuesin të zbulojë veten edhe brenda botës së tij.*

1 pikë Nëse shpjegon domethënien e fjalisë.

1 pikë Nëse zbërthen efektin kuptimor.

1 pikë Nëse zbërthen efektin stilistik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 2 pikë**➤ E veçanta e fjalisë përmbyllëse**

- *Ndërtimi vjen i figurshëm (metaforë). Nën atë shëmb djali zbuloi pasionin tek vetja, i dha formë këtij pasioni, i dha një emër.*
- *Fjali e shkurtër pohore, që është përfundimi dhe mesazhi i pjesës.*

➤ Arsyeja e kësaj zgjedhjeje:

- *Autori zgjedh ta mbyllë tekstin pikërisht me një shprehje të tillë të figurshme, në mënyrë që mesazhi i pjesës të mbetet në memorien e lexuesit dhe madje ta nxisë drejt njohjes së pasionit..*

1 pikë Nëse tregon të veçantën e fjalisë përmbyllëse.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II

Lasgush Poradeci

Zemra e liqerit

Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	D	1 pikë
Pyetja 17	B	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 19 2 pikë

➤ Rrafshet kuptimore

- *Kuptimi i parë*: liqeni në kuptimin e drejtpërdrejtë, liqeni i Pogradecit.
- *Kuptimi i dytë*: liqeni si vendi shpirtëror, burimi i frymëzimit, zotërues i shpirtit të poetit.

OSE

- *Kuptimi i dytë*: Poeti identifikohet me vetë liqenin, është vendlindja dhe shpirti i tij.

2 pikë Nëse identifikon dy rrafshet kuptimore që mbart figura e liqenit.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një rrafsh kuptimor që mbart figura e liqenit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 3 pikë

Analiza e plotë:

- *Atmosfera në dy strofat e para ndërtohet mbi një kundërvënie. Liqeni i qetë është në kontrast me zallin. Vala e tij e qetë ledhaton zallin e përmbujshëm, i cili është i tillë për shkak të lundrave që nisen prej tij. Fërkimi i fundit të tyre me zallin krijon një zhurmë të ashpër, kërcitëse, e cila bën kontrast me valën e qetë që thjesht e ledhaton atë (zallin).*

Analiza e pjesshme

- *Kemi një atmosferë paqeje. Vetë liqeni ngjan i qetë në sipërfaqen e tij me pasqyrimin e tij shndritës (pamja I)*
- *Kemi një breg të zhurmshëm, atmosferë aspak e qetë (pamja II).*

➤ Ilustrime

- *Dirgjet, pushon- buçet; Val' e urtë' - zallit të përmbujshëm*

2 pikë Nëse analizon në mënyrë të plotë dy pamjet që japin thelbin e atmosferës. Përgjigja e nxënësit duhet të theksojë kundërvënien që është në bazë të dy strofave të para.

OSE

- 1 pikë** Nëse analizon në mënyrë të pjesshme atmosferën.
Përgjigja përshkruan vetëm një atmosferë të përgjithshme, pa nxjerrë në pah kontrastin midis pamjes së qetë të liqenit dhe zallit të zhurmshëm.

DHE

- 1 pikë** Nëse mendimin e ilustron me detaje nga poezia.

- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nëse nxënësi jep në përgjigjen e tij vetëm ilustrimet, ai do të marrë 0 pikë.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 2 pikë

- **Qetësinë e liqenit** e prishin njerëzit, lundrat, zhurmat e jetës, vetë jeta që gjallon.
- **Detaji:** *Valë e qetë- por zalli është i përbujuhëm; nisen lundrat levorashe.*

- 1 pikë** Nëse gjen se çfarë e prish qetësinë e liqenit.

DHE

- 1 pikë** Nëse identifikon një detaj që tregon këtë gjë.

- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 3 pikë

- **Figura e tingëllimit:** Vargjet ndërtohen mbi figurën e aliteracionit.

Interpretim i plotë

- *Pasqyrimi i liqenit vjen nga poshtë lart, jo qetësisht, por me një shpërthim shndritës. Poeti nuk thotë del, shfaqet, por buçet, duke na krijuar një imazh të fortë tingullor të asaj që ndodh. Përsëritja e tingujve u, e, sh, q, n, d krijon pikërisht idenë e forcës, përplasjes, trazimit. Nuk kemi një pasqyrim dosido, por që vjen zhurmshëm, plot jetë dhe dritë.*

Interpretim i pjesshëm

- *Poeti krijon një imazh tingullor të një shpërthimi flot dritë dhe ngjyra.*

- 1 pikë** Nëse identifikon figurën e tingëllimit.

DHE

- 2 pikë** Nëse interpreton në mënyrë të plotë imazhin e krijuar.

OSE

- 1 pikë** Nëse interpreton në mënyrë të pjesshme imazhin e krijuar.

- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 23 **3 pikë**➤ **Përcaktimi i gjendjes emocionale:**

- *Gjendja emocionale e poetit vjen komplekse; e trazuar, shpërthyes, ritmike etj.*

Analiz e plotë

- *Kënga e trazuar e poetit njejtësohet me ritmin e thellë, të trazuar të liqenit. Është vetë procesi i krijimit i tillë, që kalon në gjendje të tilla në rrugën e krijimit të artit. Fjalët llahtari, plagë, kraharuar janë thelbi i kësaj gjendjeje.*

Analizë e pjesshme

- *Ka një lidhje të thellë simbolike midis liqenit dhe poetit.*
- *Ndihet në këto vargje përqsja e liqenit me shpirtin e poetit.*
- *Liqeni njejtësohet me ndjenjat e poetit.*

1 pikë Nëse përcakton gjendjen emocionale të poetit.

DHE

2 pikë Nëse analizon *në mënyrë të plotë* gjendjen emocionale të poetit

OSE

1 pikë Nëse analizon *në mënyrë të pjesshme* gjendjen emocionale të poetit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24 **2 pikë****Interpretim i plotë**

- *Titulli krijohet mbi figurën e metaforës, simbolit.*
- *Zemra e liqenit përqsaset me atë të poetit. Të dyja përjetojnë të njëjtat ndjesi, ngazëllim, vuajtje, trazim.*
- *Liqeni simbolizon edhe shpirtin e poetit, që vuan e gëzon me ritmin natyror të liqenit dhe ritmin e zhurmshëm të jetës.*
- *Liqeni-poeti, zemra e liqenit është shpirti i poetit.*

Interpretim i pjesshëm

- *Titulli vjen i figurshëm.*
- *Zemra e liqenit është vetë zemra e poetit.*
- *Liqeni nënkupton poetin.*

2 pikë Nëse zberthen në mënyrë të plotë titullin e poezisë.

OSE

1 pikë Nëse zberthen në mënyrë të pjesshme titullin e poezisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hytjen;
 - zhvillimin;
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë**

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.

